



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:064488

Datë: 22.10.2019

Numri i dokumentit: 00594880

P.nr.741/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me procesmbajtësen Bute Ramosaj – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit K.G. nga Gjakova, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupore nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së, i akuzuarit sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakove-Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP/II.nr.1366/2018, të datës 23.10.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, publik, **me datë 18.10.2019**, në prezencën e Prokurores së Shtetit Mone Sylja, të dëmtuarit B.K. si dhe të akuzuarit, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 22.10.2019, e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

K.G., nga i ati Q., e ëma Xh., e gjinisë S., data e lindjes..., ne Gjakove, i martuar, ka të kryer shkollën fillore, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, ashkali - shtetas i Republikës së Kosovës, numër personal...

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datën 10.09.2018, rreth orës 21:30 minuta, në Gjakovë p.n, i shkakton lëndime lehta trupore personit tjetër të cilat rezultojnë me dëmtim të përkohshëm të shëndetit, në atë mënyrë që për shkak të mosmarrëveshjeve paraprake, pasi që vëllai i të akuzuarit - i mituri S.G. dhe i mituri U.G., e thërrasin të dëmtuarin duke i thënë se pse je perla me shokun tonë B.H., i dëmtuari duke iu sqaruar se këtë rast e ka rregulluar me familje, në atë moment vjen i akuzuari K.G. dhe e godet të dëmtuarin, me grusht në vesh duke ia shkaktuar plagë çarëse-shqyrëse ku në atë moment kanë ndërhy njerëz te rastit dhe i kanë ndarë, më ç' rast të dëmtuarit i shkakton lëndime të lehta trupore, sipas ekspertizës mjeko-ligjore të Dr.V.H., të datës 04.10.2018.

Me këto veprime ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 parg.1 nënpar.1.4 të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 38, 69, 70, 81, 82 të KPRK-së dhe nenit 188 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

V Ë R E J T J E G J Y Q Ë S O R E

Të akuzuarit K.G., i bëhet me dije se ka kryer një vepër të dëmshme dhe të rrezikshme që përbën vepër penale dhe nëse ai sërish kryen vepër të tillë, gjykata do të shqiptojë sanksion më të rëndë penal.

Detyrohet i akuzuari që ti paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë për ekspertizën mjeko ligjore shumë prej 20 (njëzet) Euro, shpenzimet e paushallit gjyqësor shumë prej 10 (dhjetë) Euro, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit, shumë prej 30 (tridhjetë) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë- Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP/II.nr.1366/2018, të datës 23.10,2018, kundër të akuzuarit K.G. nga Gjakova, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së. Prokurorja e shtetit Mone Syla, gjatë shqyrtimit fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit, andaj ka propozuar që i njëjti të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari K.G., gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, dhe ka shtuar se është penduar tepër për këtë veprim nga se me Blendin kemi qenë gjithmonë shokë edhe tani jemi, për këtë rast jemi pajtuar, nuk kemi asgjë te keqe, prandaj i premtoj Gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të këtilla.

Prokurorja e shtetit Mone Syla, duke dhënë mendim rreth pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se: nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që i njëjti pranimin e fajësisë e bënë me vetëdije dhe vullnet të plot pa presion, i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë po ashtu pranimi i fajësisë mbështetet në provat dhe në fakte që janë bashkangjitur aktakuzës andaj i propozoj gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor për veprën penale dhe të dënohet sipas ligjit dhe të obligohet në pagesën e shpenzimeve të procedurës penale.

I dëmtuari **B.K.**, duke dhënë mendim rreth pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se: nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë me të akuzuarin, dhe ka shtuar se pas rastit pas një jave jemi pajtuar nuk kemi asgjë te keqe jemi shokë dhe punojmë bashkë me sharrë, prandaj nuk bashkëngjitem ndjekjes penale dhe nuk kërkoj kompensim demi për lëndime që me janë shkaktuar nga i akuzuari.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari K.G.: me datën 10.09.2018, rreth orës 21:30 minuta, në Gjakovë, i shkaktonte lëndime lehta trupore personit tjetër të cilat rezultojnë me dëmtim të përkohshëm të shëndetit, në atë mënyrë që për shkak të mosmarrëveshjeve paraprake, pasi që vëllai i të akuzuarit - i mituri S.G. dhe i mituri U.G., e thërrasin te dëmtuarin duke i thënë se pse je perla me shokun tonë B.H., i dëmtuari duke iu sqaruar se këtë rast e ka rregulluar me familje, në atë moment vjen i akuzuari K.G. dhe e godet të dëmtuarin, me grusht në vesh duke

ia shkaktuar plagë çarëse-shqyrëse ku në atë moment kanë ndërhy njerëz te rastit dhe i kanë ndarë, më ç'rast të dëmtuarit i shkakton lëndime të lehta trupore, sipas ekspertizës mjekoligjore të Dr.V.H., te datës 04.10.2018.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuarit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurorja e shtetit dhe çdo provë tjetër dhe së në aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së për hedhjen e aktakuzës përkatësisht pushimin e procedurës penale.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së, dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale për të akuzuarin: se është i moshës relativisht të re 20 vjeçare, jeton në bashkësi familjare prej 13 anëtarëve është mbajtës i familjes, në gjykim ka pasur qëndrim tejet korrekt, pendimin e tij duke i kërkuar publikisht falje palës së dëmtuar, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, faktin se me të dëmtuarin janë pajtuar, nuk kanë asgjë te keqe punojnë së bashku me sharrë të drunjëve dhe si dhe faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër penale. Ndërsa si rrethana posaçërisht lehtësuese gjykata vlerësoi, pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar si dhe faktin se i akuzuari është i gjendjes së dobët ekonomike. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese dhe duke marr për bazë rrethanat posaçërisht lehtësuese për të akuzuarin gjykata ka ardhur në përfundim se me shqiptimin e vërejtjes gjyqësore, do të arrihet qëllimi i vërejtjes, që të akuzuarit ti jepet qortimi, e që në rastin konkret edhe vërejtja gjyqësore është sanksion i mjaftueshëm për të arritur qëllimin e dënimit dhe qëllimin e vërejtjes gjyqësor nga neni 41 dhe 81 të KPRK-së dhe se ky sanksion i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Gjykata të dëmtuarin B.(M.)K. nga Gjakova, nuk e ka udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, ngase si njëjti gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar nuk kërkoj kompensim demi për lëndime që me janë shkaktuar nga i akuzuari.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor është marr konform nenit 450 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 453 par.1 të KPP-së, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform neneve 498 par.1 dhe 2 dhe 499 par.1, 2, 3 lidhur me nenin 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm –
P.nr.741/2018, me datë 18.10.2019

Procesmbajtësja,
Bute Ramosaj

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Mentor Bajraktari

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.